

FTESË

Konventa Kombëtare për Integrimin European 2021-2023

Grupi i Punës I (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore)

Tema: Ndikimi i legjislacionit të BE ndaj sistemit gjyqësor kombëtar, gjatë dhe pas anëtarësimit në BE

21 shkurt 2023, 16:30- 18:00

Online në Platformën Zoom

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) dhe Slovak Foreign Policy Association (SFPA) në bashkëpunim me Shkollën e Avokatisë në Shqipëri, me mbështetjen financiare të SlovakAid, kanë kënaqësinë t'iu ftojme në sesionin 3 të Grupit të Punës I fokusuar në "Ndikimin e legjislacionit të BE ndaj sistemit gjyqësor kombëtar, gjatë dhe pas anëtarësimit në BE" që po organizohet në kuadër të Konventës Kombëtare për Integrimin European 2021- 2023.

Konventa fokusohet në 3 drejtime kryesore: 1) rritja e pjesëmarrjes së të gjithë segmenteve të shoqërisë shqiptare (përfshirë edhe nivelin lokal); 2) institucionalizimi i debatit publik në çështjet e BE-së bazuar në bashkëpunimin e institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile dhe ato të biznesit; dhe 3) forcimi i kapaciteteve në negociatat për integrimin në BE përmes transferimit të njohurive sllovaqe.

Në sajë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me ministritë dhe agjencitë kyçe gjatë periudhës 2014-2021 si Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, janë krijuar disa grupe pune për të adresuar kapitujt më sfidues të negociatave të Acquis së BE-së. Gjatë Konventës 2021-2023 po organizohen 16 sesione për katër Grupe Pune, më konkretisht: GP I – Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore (Kapitulli 23); GP II – Drejtësia, Liria, Siguria (Kapitulli 24); GP III – Bujqësia dhe Mbrojtja e Konsumatorit (Kapitulli 11, 12 dhe 28); GP V – Çështjet e Tregtisë dhe Ekonomisë (Kapitulli 1, 2, 3, 4 dhe 20).

Grupi i Punës I, falë eksperiencës së ekspertëve, po shqyrton dhe diskuton tema në fushën e të drejtave themelore, luftës ndaj korrupsionit, reformës në drejtësi dhe procesit screening për Kapitullin 23. Më shumë se 10 sesione janë organizuar për këtë Grup Pune gjatë Konventës, ndërkohë që për periudhën 2021-2023 janë parashikuar të zhvillohen **katër sesione**. Këto sesione bashkë-drejtohen nga përfaqësues të institucioneve shtetërore, institute akademike, shoqëria civile dhe ekspertë të brendshëm të Konventës.

Aktivitetin mund ta ndiqni në Platformën Zoom:

Zoom Link:

<https://us06web.zoom.us/j/88582412349?pwd=eGREekRsRy9WcmowK0ovamxudFJjUT09>

Meeting ID: 885 8241 2349

Passcode: NCEI-AL

Ju lutemi konfirmoni pjesëmarrjen në: info@em-al.org.

**Gjatë prezantimit të ekspertit sllovak do të ofrohet përkthim në gjuhën shqipe*

PROGRAMI

Konventa Kombëtare për Integrimin European 2021-2023

Grupi i Punës I (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore)

Tema: Ndikimi i legjislacionit të BE ndaj sistemit gjyqësor kombëtar, gjatë dhe pas anëtarësimit në BE

21 shkurt 2023, 16:30- 18:00

Online në Platformën Zoom

16:15 – 16:30 Regjistrimi i pjesëmarrësve

16:30 – 16:35 Hapja e aktivitetit

Nirvana Deliu, Hulumtuese Politikash, Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)

16:35 – 17:00 **Impakti i së drejtës së Bashkimit European në legjislacionin Shqiptar**

Gentjan Skara, Ph.D., Shef i Departamentit të Drejtësisë, Universiteti Bedër

- *Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) dhe impakti në legjislacionin shqiptar*

- *Detyrimi për përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të Bashkimit European – rast praktik: E drejta e konkurrencës*

17:00 – 17:40 **Si legjislacioni i BE ndikon në sistemin ligjor të vendit aspirant gjatë proces të anëtarësimit – Rasti i Sllovakisë**

Radovan Pala, Ph.D. LL.M & Kristina Kesnerova, Taylor Wessing Sllovaki

- *Roli i marrëveshjeve me BE përpara anëtarësimit (p.sh Marrëveshjet e Asociimit)*

- *Ndikimi që ka në sistemin e drejtësisë të vendit aspirant përpara dhe pas anëtarësimit*

- *Mekanizmi i ri i BE për Shtetin e së Drejtës – efektet e tij tek institucionet dhe/ose debatin publik*

17:40 – 18:00 *Diskutim i hapur me pjesëmarrësit*